

V E N D I M

Nr.390, datë 6.8.1993

PER RREGULLAT E PRODHIMIT, ADMINISTRIMIT, KONTROLLIT DHE RUAJTJEN E VULAVE ZYRTARE

Me qëllim që të krijohet një regjim i fortë në prodhimin, administrimin, kontrollin dhe ruajtjen e vulave zyrtare, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Personat juridikë që ushtrojnë veprimtari në Republikën Shqipërisë detyrohen të kenë vulën e tyre zyrtare prej gome ose plastike me simbolet dhe shënimet e nevojshme identifikuese.
2. Vula zyrtare e personave juridikë shtetërorë duhet të ketë diametrin 30 mm. Në qendër vendoset stema dhe rreth saj shkruhet "Republika e Shqipërisë" e shënimet e nevojshme për identifikimin e personit juridik.
3. Personat juridikë të lejuar posaçërisht nga Këshilli i Ministrave, kanë të drejtë që përveç vulës prej gome ose plastike të mbajnë në një ose më shumë ekzemplarë edhe vulë metalike (vulë e thatë).
4. Vulat prodhohen në punishte të posaçme shtetërore ose private që caktohen dhe pajisen me licencë nga Ministria e Rendit Publik. Punishtja duhet të jetë e siguar me roje të armatosura.
Rregullat për pajisjen me licencë caktohen nga Ministria e Rendit Publik.
5. Prodhimi i vulave bëhet në një ekzemplar të vetëm, të dhënat e të cilëve regjistrohen në kompjuterin e Ministrisë së Rendit Publik. Bëhet përjashtim nga ky rregull në rastet kur veprimtaria e personit juridik ushtrohet në më shumë se një zyrë sekretarie si dhe kur parashikohet me dispozita të veçanta.
6. Personat juridikë për t'u pajisur me vulë zyrtare duhet të paraqesin kërkesën me shkrim dhe modelin përkatës, të cilat i dërgohen drejtpërdrejt punishtes së caktuar nga Ministria e Rendit Publik.
7. Vulat zyrtare shtetërore ruhen në zyrat sekrete. Atje ku nuk ka të tilla ruhen në kasaforta metalike të siguruara me çelës.
8. Nuk lejohet përdorimi në dokumente i vulave që për shkak të përdorimit të gjatë të tyre janë bërë të palexueshme. Ato asgjësohen me procesverbal. Kur vula humbet mbahet procesverbal dhe njoftohen menjëherë organet e rendit publik.
9. Ndalohet përdorimi në dokumente i vulave që nuk kanë emërtime të sakta, vendosja e tyre në dokumente të nënshkruara nga persona jo kompetentë, dhënia e vulës për përdorim personave të pa autorizuar, nxjerrja jashtë objekteve të përcaktuara si dhe lënia pa siguar e tyre.

10. Për kontrollin e zbatimit të rregullave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Ministria e Rendit Publik.

11. Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 25.7.1978 "Për vulat zyrtare dhe aparatet shumëzuese për botim" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI

errmbajtja: REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

VENDIM
Nr.220, datë 1.4.1996

PER BLERJEN E LENDEVE TE PARA DHE MATERIALEVE TE NEVOJSHME
PER PRODHIMIN E VULAVE ZYRTARE

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Blerjen e lëndëve të para dhe materialeve të nevojshme për prodhimin e vulave zyrtare nga Ministria e Brendshme me prokurim të derjtpërdrejtë pranë firmës "BONACINA" Itali.
2. Cmimi i shitjes së vulave caktohet nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.
3. Të ardhurat e siguruara nga shitja e vulave do të derdhen në buxhetin e shtetit dhe do të përdoren:
 - Në formën e rikthimeve në të njëjtën masë me shpenzimet operative të shpenzuara paraprakisht për këtë qëllim.
 - Pjesa tjetër do të derdhet në buxhetin e shtetit në formën e të ardhurave nacionale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI